

UDHËZIM
Nr.10, datë 23.3.2010

**PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR.1, DATË 8.1.2009 “PËR PËRCAKTIMIN E
TARIFËS SË SHËRBIMIT PËR PËRDORIMIN E APARATEVE TELEVIZIVE”**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës dhe nenit 11 të ligjit nr.9975, datë 28.7.2008 “Për taksat kombëtare”, Ministri i Financave dhe Drejtori i Përgjithshëm i Radiotelevizionit Shqiptar

UDHËZOJNË:

Në udhëzimin nr.1, datë 8.1.2009 “Për përcaktimin e tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televizive”, pika 7 riformulohet si më poshtë:

“7. Për shërbimin e kryer, OSSH-ja përfiton 10% komision të llogaritur mbi masën e tarifave që ka arkëtuar dhe ka transferuar në llogarinë përkatëse të thesarit.”.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I
RADIOTELEVIZIONIT SHQIPTAR
Petrit Beci